



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 338 prot.

Gramsh, më 29/09/2022

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në mbështetje të ligjit nr.69/2012, datë 21.06.202 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 17; Udhëzimit nr.30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”(i ndryshuar); Shkresës nr.1426, datë 15.09.2022, “Dërgim liste portali të kandidatëve të arsimit parashkollor” të Zyrës Arsimore Gramsh, protokolluar me tonën nr.3738, datë 16.09.2022; shkresës nr 3724, datë 15.09.2022 “Kërkesë” të punonjësës Anxhela Koçi; Vendimit nr.89, datë 16.09.2022 “Për lirim nga detyra të punonjësit mësimor Zj.Anxhela Koçi”, të Kryetarit të bashkisë; Vendimit nr.85, datë 08.09.2022 “Për transferim punonjësi mësimor” nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele të detyrueshme/me dëshirë, të edukatores në kopshtin e fshatit Gjergjovinë, Bashkia Gramsh shpall vendet e lira të punës “për edukatore në arsimin parashkollor” si më poshtë vijon:

Lista e vendeve të lira dhe profilet

Nr.	Institucioni Arsimor	Profili mësuesi	Statusi/Afati
1.	Kopshti në fshatin Kishtë, Bashkia Gramsh	Mësues i arsimit parashkollor APSH	Pa afat
2.	Kopshtin në fshatin Storr, Bashkia Gramsh	Mësues i arsimit parashkollor APSH	Me afat

Njoftohen të gjithë fituesit e portalit “Mësues për Shqipërinë”, profili APSH, të interesuar për punësim, sipas profileve të shpallura, të paraqiten ditën e premte më datë 30.09.2022 ora 14⁰⁰, në ambjentet e Bashkisë Gramsh, salla e mbledhjeve, ku do të zhvillohet mbledhja e Komisionit të Vlerësimit, për plotësimin e vendeve të shpallura të lira.

Klodian TACE
KRYETARI